

Faza e parë e restaurimit në kishën e Shën Marisë në Niçe të Korçës



Në malësitë e Gorës, midis peizazhit të jashtëzakonshëm dhe terrenit të thyer ndodhet fshati Niçe, i cili në shekullin e 18-të ka qenë një prej zonave më të zhvilluara në periudhën e lavdishme të Voskopojës dhe Grabovës, e banuar nga popullsia Vlehe.

E njohur nga historia si një qytet mesjetar e krijuar që në shekullin X nga fiset armene (vllahe) dhe vazhdon të mbetet një nga ikonat historike më pak e folur dhe e shkruar për vlerat që mbart në historinë e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Niça në të shkuarën ka qenë nga vendbanimet armene më të hershme dhe më të populluara pas Voskopojës, e cila flet për kulturën dhe civilizimin romak e bizantin që mbarte në historinë e saj. Ajo ka qenë dhe një nyje lidhëse në rrugën e vjetër "Egnatia", ku njëra nga degët kalonte në Grabovë dhe shtrihej pastaj drejtë

Shqipërisë së Mesme dhe asaj verilindore. Nga lavdia e dikurshme ka mbetur vetëm Kisha e Shën Marisë ndërtuar sipas mbishkrimit në vitin 1749, një nga 3 urat e vjetra dhe derstila në afërsi të saj.

Kisha e rishpallur monument kulture në vitin 2015 është një dëshmi e qartë e qytetërimit, dhe zhvillimit, e restauruar në fillim të luftës të parë botërore nga vullnetarët e trupave franceze dhe banorët e zonës në mënyrë naive, sot ndodhet në një gjendje jo të mirë.

Piktura murale në brendësi të saj shfaq disa skena të rralla dhe unike, të pikturuara nga Vëllezërit Jeromonahu dhe autorë të tjerë të panjohur.

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Korçë ka bërë të ditur se ka nisur faza e parë e restaurimit e cila parashikon shmangien e riskut të objektit dhe zgjidhjen e disa problematikave emergjente.

Sipas DRKK-së, kjo ndërhyrje po bëhet me qëllimin kryesor që kjo nismë të pasohet edhe me të tjera ndërhyrje edhe në infrastrukturë për të promovuar vlerat dhe potencialin e jashtëzakonshëm kulturor dhe natyror që ka kjo zonë.

FOTO

- [ATSH](#)